



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 238/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej znj. Nita Bejta - Kryetar, z. Vedat Poterqoi- Anëtarë, z. Agon Ramadani – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “NTSH Unisoft” - Prishtine, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit: “Ofrimi i shërbimeve të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të studenteve dhe stafit të Universitetit dhe mirëmbajtja e tij” me nr. prokurimi: 10208-22-5456-2-2-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Universiteti Ukshin Hoti Prizren, më datën: 18. 08. 2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NTSH Unisoft” - Prishtine, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit: “Ofrimi i shërbimeve të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të studenteve dhe stafit të Universitetit dhe mirëmbajtja e tij” me nr. prokurimi: 10208-22-5456-2-2-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Universiteti Ukshin Hoti Prizren.

II. VERTETOHET, vendimi i AK- Universiteti Ukshin Hoti Prizren për njoftim për kontratë të aktivitetit të prokurimit “Ofrimi i shërbimeve të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të studenteve dhe stafit të Universitetit dhe mirëmbajtja e tij” me nr. prokurimi: 10208-22-5456-2-2-1.

III. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar

me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Me datën: 28.06.2022, "NTSH Unisoft - Prishtine" ka parashtruar ankesë me nr: 238/22, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit: "Ofrimi i shërbimeve të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të studenteve dhe stafit të Universitetit dhe mirëmbajtja e tij" me nr. prokurimi: 10208-22-5456-2-2-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Universiteti Ukshin Hoti Prizren.

OE ankues në ankesë pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 1,7,dhe 35 të LPP-së si dhe nenet 6,7,8 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 29. 06. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 07. 07. 2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:

Përgjigje në pretendimin Ankimor 1:

Ne raportin e negociatave me nr., Protokolli: 03-123/A datë: 04.05.2018 neni 4: citohet SMU -Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm NTSH UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studenteve, profesorëve i përkasin AK- Universitetit Ukshin Hoti. Dokument ky i nënshkruar nga komisioni negociues në kuadër të AK-se dhe përfaqësuesi i kompanisë në kuadër të OE. Ne kontratën e nënshkruar me AK dhe OE date 15.05.2018 neni 6 -Raporti i Negociatave pika 63 SMU - Sistemi i Menaxhimit Universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave i përket vetëm NTSH UNISOFT, ndërsa shënimet dhe të dhënat e studenteve, profesorëve i përkasin AK- Universitetit Ukshin HOTI. Ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2:

AK - Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren nga data 15.05.2021 deri tani vazhdon ta shfrytëzoj SMU - Sistemi i Menaxhimit Universitar, pa kontratë. Përkundër që AK- Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren dhe asnjë institucion publik, me ligjet në fuqi nuk kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë/marrin shërbime apo mallra të cilat janë të pa kontraktuara. Ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3:

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues mbi shkeljen dhe diskriminimin, konsideron që AK - duhet të ketë parasysh të gjitha implikimet të cilat mund

te jene dhe te rrjedhin, pasi qe ka ne shfrytëzim sistem, pronësia e kodit te të cilit dhe skemës se bazës se te dhënave i përket OE ankues. Në këtë sistem nuk mund të bëhen ndryshime të cilat mund ti duhen AK-së, si dhe nuk mund te ketë siguri qe OE ankues edhe me tutje do te lejoj shfrytëzimin e këtij aplikacioni. Edhe ne rast se OE do ta lejonte shfrytëzimin e këtij sistemi, AK nuk mund te marre shërbime te pa kontraktuara.

AK - mund ti kryej te gjitha procedural e prokurimit konform kërkesave nga njësia kërkuese dhe specifikave dhe nëse, për arsye te mbrojtjes se te drejtave te pronës intelektuale apo industriale apo te drejtave ekskluzive. AK mund ti kryej te gjitha procedural e prokurimit te parapara me LPP dhe RRUOPP. Ky pretendim është i bazuar

Përmbyllje e ekspertizës (Citim nga Ekspertiza 485/21 date 30.06.2021):

Eksperti shqyrtues i prokurimit sqaron qe AK duhet te ketë kujdes qe te hartoj specifika teknike te cilat nuk krijojnë implikime ne kontratat para-ardhëse dhe pas-ardhëse. Aplikacionet dhe licencat softuerike janë fusha te ndjeshme ashtu qe hartimi i specifikave teknike duhet te jete i sakte për nevojat e AK-se. Sa i përket procedurës ne fjale, nëse kjo procedure vazhdon më tutje, do te ketë implikime dhe probleme ne ekzekutimin e kontratës nga AK dhe OE fitues, meqenëse OE ankues i takon e drejta e pronës intelektuale apo industriale (Autorësia dhe pronësia e kodit burimor te aplikacionit dhe skemës se bazës se te dhënave).

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar ne analizimin e dosjes, specifikave te tenderit, pretendimeve dhe fakteve te ofruara, sqarimet dhe te gjeturat ne këtë ekspertize, konsideroj qe ankesa e OE ankues te aprovet si e bazuar, paneli shqyrtues te sjell vendim për anulimin ne tërësi te aktivitetit te prokurimit, si dhe i njëjti te ri-tenderohet konform kërkesave dhe specifikave te parapara me LPP dhe RRUOPP.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 12 Korrik 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues Universiteti Ukshin Hoti Prizren me datën 18 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Operatori ekonomik ankues “NTSH Unisoft” - Prishtine” me datën 14 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datën: 18 Gusht 2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, deklaratave te palëve ne procedure, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Operatorin ekonomik e ka përfaqësuar zt. Arianit Bytyqi i cili deklaroi se qëndron prapa pretendimeve ankimore dhe sqaroi se: ne si OE “Unisoft” kemi pas një kontratë për shërbime te njëjta kontratë kjo për sistemin e menaxhimit universitar, kontratë e cila ka qen kornizë dhe ka përfunduar me datën 14.05.2021 gjatë raportit te negociatave ne nenin 4 shkruan qe sistemit te menaxhimit universitar autorësia dhe pronësia e kodit burimore te aplikacionit i përket

vetëm “Unisoft”, ndërsa shënimet dhe te dhënat e studenteve dhe stafit i përkasin AK-se.

Në pyetjen e panelit shqyrtues se me këtë kod burimor i cili i përket OE ankuese a mund të migrohen te dhënat me një sistem të ri? I njëjti përgjigjet se kjo mund të bëhet mirëpo donë një kohë të jashtëzakonshme me të gjatë se pari duhet të bëhet analiza dhe skema e bazës paraprake të bëhet analiza e një baze të re dallimet mes tyre dhe pastaj duhet të krijohet një vegël programuese që të realizohet migrimi gjithsecila pikë prej detyrë merr kohën e vetë e cila nuk mund të kryhet as për 10 ditë sipas kërkesës së AK as për një kohë me të gjatë.

Aktualisht gjendja është edhe më e vështirë për shkak se institucioni është pa kontratë prej vitit 2018 kur kemi nënshkruar kontratën e parë në raport të negociatave 115 thotë që postimi i aplikacionit nuk është pjesë e marrëveshjes në këto negociata e as në dosjen e tenderit.

Përfundimisht përfaqësuesi i OE ankuese propozon që të anulohet ky aktivitet i prokurimit të ndryshohen termat e referencës.

Në vazhdim fjalë iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Kryeziu i cili deklaroi: na realisht e kemi pas një procedurë një kontratë e kemi pas të planifikuar me zhvillu një procedurë të hapur edhe e kemi iniciuar, specifikat të cilat janë hartuar në këtë procedurë janë hartuar prej një grupi të ekspertëve të Universitetit dhe profesor të IT dhe janë përgatit në bazë të rregullores të universitetit që na duhen sipas nevojave tona duke i ia përshtat kërkesave dhe rekomandimeve të agjencionit të akreditimit. Ne jemi duke kërkuar një sistem për menaxhimin e të dhënave të studenteve dhe profesorëve dhe mirëmbajtje e që në këtë rast mundet me kanë SMU ose ekuivalent me SMU me marrë në shfrytëzim edhe me mirëmbajtje.

I njëjti vazhdon sqarimin duke deklaruar se: në këtë aktivitet kontestohet se a duhet të jetë procedurë e hapur apo e negociuar, dhe nëse si AK propozojmë të kemi procedurë të hapur me që në treg ka edhe OE tjerë që ofrojnë shërbime të njëjta.

Në pyetjen e panelit shqyrtues se a është e mjaftueshme të bëhet migrimi i të dhënave brenda 10 ditëve siç është specifikuar të Specifikat Teknike. I njëjti përgjigjet se sipas ekspertëve të brendshëm të IT kjo kohë është e mjaftueshme. Përfundimisht AK kërkon nga PSH që të refuzohet ankesa dhe të mbetet në fuqi njoftimi për kontratë dhe të zhvillohet aktiviteti i i prokurimit me procedurë të hapur.

Në vazhdim fjalë iu dha ekspertit shqyrtues z. Shala i cili deklaroi se qëndron prapa raportit të ekspertizës dhe parashtroj pyetje për AK: të dhënat nga data 15.05.2021 që i ka OE që i ka marrë shërbimet ku përfundojnë të dhënat e studentëve, profesorëve etj?

Në të cilën AK përgjigjet se në kontratën e kaluar që ka përfunduar në 2021, OE është obliguar që me datën 15 Maj të kthejë të dhënat.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimin e parë ankimor se në bazë të Kontratës paraprake të nënshkruar në mes të OE ankuese dhe AK – Universitetit Ukshin Hoti, autorësia dhe pronësia e kodit burimor të aplikacionit, skemës së bazës së të dhënave të Sistemit të Menaxhimit Universitar i përket vetëm NTSH UNISOFT andaj AK me iniciimin e procedurës së prokurimit për “Ofrimi i shërbimeve të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të studenteve dhe stafit të Universitetit dhe mirëmbajtja e tij” ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-se. Paneli shqyrtues pas administrimit të provave dhe në bazë të deklarimeve në seancë, nuk mbështetet në raportin e

ekspertit dhe konstaton se inicimi i aktivitetit të prokurimit nga AK për një procedure të hapur nuk përben shkelje të nenit 7 të LPP-se dhe se ky aktivitet i prokurimit në baze të përshkrimit Specifikave Teknike parasheh marrjen në shfrytëzim të një sistemi të ri elektronik për menaxhimin e të dhënave të studenteve dhe stafit për Universitetin dhe mirëmbajtjen e tij për 36 muaj. Kjo procedure e hapur jep mundësi që çdo Operator tjerë në këtë rast edhe operatorit ekonomik ankues të paraqet oferte me qëllim që të rritet konkurrenca andaj paneli shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si të pa bazuar.

Për më tepër, AK në Specifikat Teknike ka parapare edhe migrimin e të dhënave nga sistemi paraprak në një sistem të ri në afat kohor 10 dite, e për të cilin OE ankuese në seance ka deklaruar se kjo procedure është e mundur edhe pse të njëjtit kanë kodin burimor të sistemit paraprak mirëpo, kjo procedure merr më shumë se 10 dite kohë për tu realizuar, andaj AK duhet ta sigurojë mundësinë e realizimit të kësaj procedure në afat prej 10 ditëve.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimorë se AK vazhdon ta shfrytëzojë pa kontratë Sistemi i Menaxhimit Universitar, PSH konstaton se në sqarimet e ofruara nga AK të datës 16.06.2022, konstatohet se aktualisht AK nuk ka në shfrytëzim ndonjë sistem të tillë dhe për këtë arsye ka iniciuar aktivitet të ri të prokurimit me synim që të kontrakttoj marrjen në shfrytëzim të një sistemi të ri dhe mirëmbajtjen e tij, andaj ky pretendim nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e OE ankuese se janë shkelur neni 35 pika 2.1 të LPP-se dhe nenet 6,7,8 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, lidhur me paragrafin të cilit i referohet OE ankuese e i cili thotë: *Autoriteti kontraktues mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e çfarëdo kontrate publike: (ii) nëse, për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i ipet vetëm një operatori të caktuar ekonomik*. Paneli shqyrtues sqaron se nuk mund të aplikohet kjo dispozite ligjore meqë AK ka iniciuar aktivitet të ri të prokurimit dhe nuk do ta shfrytëzon pronësinë intelektuale të OE ankuese në këtë procedure mirëpo do të merr në shfrytëzim një sistem të ri. Andaj konstatohet se ky pretendim është i pabazuar,

Vendimi lidhur me konfiskimin e tarifës u dha në kuptim të nenit 31 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores së punës së OSHP-se.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryetare e PSH-së

Znj. Nita Bejta



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Universiteti Ukshin Hoti – Prizren

1x1 OE "NTSH UNISOFT" - Prishtine

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.